

Fjalimi i ministres së Kulturës Bisera Kostadinovska-Stojçevska në Këshillin e Evropës, Konferenca e ministrivë të kulturës në Starsburg

A mund të imagjinojmë që në Evropë përsëri ka luftë?! A mund të imagjinojmë që Kontinenti i Vjetër, djepi i trashëgimisë kulturore, përsëri përjeton shkatërrim katastrofal në dëshmitë e tij historike.

Ndërsa imagjinonim dhe besonim që pikërisht kultura dhe arti duhet të pëtgaditen për rolin e tyre më të mirë në rimëkëmbjen e botës postpandemike. Teatret duhej të ishin terapi për shpirtrat tanë.

A mund të imagjinojmë që ato, teatret, sot diku janë strehim për njerëzit në dëshpërim, me shpresë se aty vdekjes do t'i shmangen?! Pamë qindra fëmijë, gra dhe persona të rraskapitur që ishin strehuar në teatrin e Mariupolit. As teatri dhe as qyteti nuk egzistojnë më, ndërsa njerëz ka gjithnjë e më pak. A mund të imagjinonim diçka të tillë?

Në këtë Konferencë, shpreh falënderim ndaj Italisë dhe Këshillit të Evropës, tema është vlera e paçmueshme e trashëgimive tona kulturore. Si t'i mbrojmë dhe ruajmë përmes procesit të dixhitalizimit dhe si ti bëjmë atraktive për gjeneratat e reja. Por, një JO e madhe hyri në jetët tona. Për këtë shkak shfrytëzoj mundësinë që të shpreh mbështetje nga vendi im për iniciativën e aksionit të koordinuar për ndihmë, për shpëtimin e kulturës ukraineze dhe trashëgimisë kulturore.

Ne, në Maqedoninë e Veriut, nuk kemi përvojë shumëvjeçare me dixhitalizimin, por pounojmë intenzivisht në të dhe në dobinë e përfitimeve nga teknologjia inteligjente në evidentimin, ruajtjen dhe prezentimin e trashëgimisë tonë kulturore materiale dhe jo materiale.

Nëse pandemia e KOVID-19 na detyroi që të kërkojmë mbështetje dhe ndihmë nga bota virtuale, në teknologjitë e reja, agresioni mbi Ukrainën i dha rëndësi edhe më të madhe procesit të dixhitalizimit. Shpreh respekt të thellë dhe të sinqert kundrejt të gjithë punëtorëve dhe ekspertëve kulturor të cilët natë e ditë strehojnë artin dhe identitetin kulturor të kësaj pjese të rëndësishme të kulturës sllave, por edhe asaj botërore.

Ne duhet t'i ndihmojmë Ukrainës në shpëtimin, pastaj në dixhitalizimin e të gjithë vprave të rëndësishme që ato të mos bëhen pjesë e tregtisë me vepra artistike të vjedhura në tregun e zi. Ky evidentim është jashëtzakonisht i dobishëm dhe duhet ta posedojnë të gjithë institucionet përkatëse, përfshirë edhe Interpolin. Ukraina është e plagosur, por nuk duhet të jetë e plaçkitur.

Sulmi mbi Ukrainën është sulm mbi vlerat evropiane, sulm mbi të drejtën themelore njerëzore që të jetoj në liri dhe demokraci, të krijoj dhe mbroj kulturën e tij. Evropa po rimëkëmbet, mobilizohet për të ndihmuar në mbrojtjen e këtyre vlerave. Sepse pasuritë kulturore në vendet tona janë dhe identitet kulturor evropian të cilit diversiteti ynë vetëm se i shton ngjyrë. Këshilli i Evropës është adresa e vërtetë dhe më e vjetër e asaj ngjyre dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit njerëzorë.

Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore i një vendi është shkatërrimi i së kaluarës së tij, por edhe i së kaluarës së Evropës.

Unë nuk mund të imagjinoj Botë pa veprat e Da Vinçit,të Mikelanxhelos,Mone Pikasos...Nuk mund të imagjinoj Botë pa muzikën e Mocartit,Çajkovskit,Betovenit..Nuk mund të imagjinoj Botë pa fjalët e Heminguejit,motrave Bronte,Dostojevskit..Por,mund të imagjinoj Botë pa luftën e Putinit.

Kultura së shpejti do t'i ndërtoj përsëri urat e shembura, por nuk do të mund që t'u zbardh fytyrat e atyre që talentin e tyre bujar e vënë në shërbim të agresionit me "emër artistik" – "operacion i veçantë".

Kultura dhe arti janë emocion i dhuruar. Prandaj janë të çmuara.

„Imagjinoni të gjithë njerëzit të jetojnë vetëm sot....“- përmes këngës do të pyesë Xhon Lenon. Po, gjithnjë e më shumë mund ta imagjinoj këtë. Për këtë shkak dixhitalizimin e pasurisë kulturore e kuptoj si trashëgimi të vetme.